

VENDIM
Nr.491, datë 23.7.2004

PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT TË VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE TË SHOQËRISË “KAMBERI CO” SHPK, NË ADMINISTRIM ME TË ADHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETETEVE

(Ndryshuar me vendimin nr. 522, datë 8.7.2005)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë “Kamberi Co” sh.p.k., në administrim, sipas koeficientit të kthimit të shumave, të llogaritur si raport i të ardhurave të realizuara dhe të depozituara në bankë nga shitja e aseteve dhe e shumës së detyrimit të shoqërisë ndaj kreditorëve, si më poshtë vijon:

1.1 Të ardhurat financiare, të realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë “Kamberi Co” sh.p.k., në administrim dhe të depozituara në bankë, në llogari rrjedhëse dhe llogari depozite janë 587 000 000 (pesëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “Kamberi Co” sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve 5 798 129 817 (pesë miliardë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

1.3 Koeficienti i kthimit të shumave kreditorëve është 10,2 për qind.

2. Shpërndarja e vlerave financiare të kryhet nga degët e *Bankes Kombëtare Tregtare* në rrethet Vlorë, Tiranë, Fier dhe Sarandë, sipas një marrëveshjeje të veçantë, që do të lidhet ndërmjet grupit mbikëqyrës dhe kësaj banke. Shpërndarja e vlerave financiare kreditorëve fillimisht të kryhet me mjetet monetare, gjendje në llogarinë rrjedhëse, dhe më pas me vlerat financiare të llogarisë depozitë, sipas kërkesës së paraqitur nga administratori i pavarur i shoqërisë në *Banken Kombëtare Tregtare*, në fund të çdo tremujori.

3. Shpenzimet për shërbimet në sportelet e *Bankes Kombëtare Tregtare*, për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Kamberi Co” sh.p.k., në administrim, të përballohen nga plani financiar i grupit mbikëqyrës, zëri “Shpenzime”, në përfundim të shlyerjes të vlerave financiare kreditorëve.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, grupi mbikëqyrës dhe administratorët e pavarur të shoqërisë “Kamberi Co” sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano